

KËRKESË
Nr. 127, datë 8.6.2022

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR SHËRBIMIN E KONSULENCËS “STUDIM
NË VIJIMËSI (PASUES) MBI ANALIZËN E VARFËRISË DHE TË NDIKIMIT
SOCIAL (PSIA), PËR TË MATUR DHE PËR TË NDJEKUR GABIMET E
PËRFSHIRJES DHE TË PËRJASHTIMIT TË REFORMËS SË PAK-së, PASI TË
JETË SHTRIRË TË PAKTËN NË GJYSMËN E VENDIT, DUKE PËRFSHIRË DHE
NJË STUDIM PËR VLERËSIMIN E PËRFITIMIT PËR PËRFITUESIT E PAK-së”,
PËRFITUES I SË CILËS ËSHTË MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
REF. NO. SAMP/CS/CQ/01-2022**

Tiranë, 8 qershor 2022

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Nr. i huas: 8841 - AL

Nr. ID i projektit: P162079

Republika e Shqipërisë ka marrë financim (shitesë) nga Banka Botërore për koston e financimit shitesë të Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP), dhe synon të aplikojë një pjesë të të ardhurave për shërbimet e konsulencës. Shërbimet e konsulencës (Shërbimet) përfshijnë “Studim në vijimësi mbi analizën e varfërisë dhe të ndikimit social, për të matur dhe për të ndjekur gabimet e përfshirjes dhe të përjashtimit të reformës së PAK-së, pasi të jetë shtrirë të paktën në gjysmën e vendit, përfshi dhe një studim për vlerësimi e përfitimit për përfituesit e PAK-së”.

Shërbimet e konsulencës (Shërbimet) përfshijnë dy komponentë:

a) Komponenti kërkimor sasior, që do të anketojë personat me aftësi të kufizuara, që kanë marrë vërtetim aftësie të kufizuar kohët e fundit, dhe personat me aftësi të kufizuara, që iu refuzua dhënia e këtij vërtetimi.

b) Komponenti kërkimor cilësor, që synon intervistimin e personave me aftësi të kufizuara për të kuptuar nivelin e kënaqësisë së tyre me sistemin e ri të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Kësaj kërkesë për shprehje interesi i bashkëlidhen termat e detajuara të referencës (TOR) për këtë detyrë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përmes Ekipit të Menaxhimit të Projektit (PMT), tani fton kompanitë vendore të kualifikuara (Konsulentët) të tregojnë interesin e tyre për ofrimin e shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që tregon se kompania ka kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse për të kryer shërbimet.

Konsulentët e interesuar duhet të jenë në gjendje të angazhojnë anketues të kualifikuar, staf për hedhjen e të dhënave, kontrollorë cilësie dhe staf analitik, sipas dakordësimit në kontratë dhe duhet të zotërojnë kapacitetin logjistik për të kryer anketimin brenda afatit kohor të studimit.

Konsulenti duhet të ketë një historik të dëshmuar me kryerjen e detyrave të ngjashme.

Kriteret minimale të kualifikimit për përzgjedhje janë:

- konsulenti duhet të jetë një organizatë e themeluar me të paktën 3 vjet ushtrim veprimtarie;
- konsulenti duhet të ketë realizuar të paktën një anketë të ngjashme në 5 (pesë) vjetët e fundit.

Kriteret e vlerësimit dhe pikët përkatëse janë si vijon:

- Përkshkrimi i profilin të shoqërisë; historiku përkatës dhe stafi (30 pikë);
- Përkshkrimi i punëve/veprimtarive më me rëndësi dhe të ngjashme në 10 vjetët e fundit, që tregojnë aftësitë e duhura të mbledhjes së të dhënave, analizës së të dhënave, pyetësorëve, aftësive intervistuese dhe monitorimit. Dhënie e informacionit lidhur me veprimtari të përfunduara dhe/ose në proces: emri i veprimtarisë/projektit, burimi i financimit, kostoja, kohëzgjatja, roli si partner i vetëm dhe/ose anëtar i një SP-je (70 pikë/7 pikë për çdo anketë të

ngjashme dhe 5 pikë për anketa në shkallë më të vogël, me një shumë kumulative prej 70 pikësh gjithsej);

Konsulentët e interesuar duhet t'i kushtojnë vëmendje seksionit III, paragrafët 3.14, 3.16 dhe 3.17 të "Rregulloreve të prokurimit për huamarrësit IPF", të Bankës Botërore, datë korrik 2016 (Rregulloret e prokurimit), në të cilët përcaktohet politika e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera për të rritur kualifikimet e tyre, por duhet të tregojnë qartë nëse bashkimi është në formën e një sipërmarrjeje të përbashkët dhe/ose një nënkonsulencë. Në rastin e një sipërmarrjeje të përbashkët, të gjithë ortakët në sipërmarrjen e përbashkët do të jenë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për të gjithë kontratën, nëse zgjidhen.

Një konsulent do të zgjidhet në përputhje me metodën e përzgjedhjes së bazuar në kualifikimet e konsulentit (CQS) të përcaktuar në Rregulloret e prokurimit.

Informacione të mëtejshme mund të merren në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës nga 08:00 deri në 16:30 (e hënë në të enjte) dhe nga ora 08:00 deri në 14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (personalisht ose me postë, ose me faks, ose me *e-mail*) deri më **29 qershor 2022**.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)
Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – kati 1
Rruga e Kavajës, nr. 53, AL-1001, Tirana, Albania
Att: Suzana Papadhopulli
E-mail: samp.papadhopulli@gmail.com

TERMAT E REFERENCËS

Studim në vijim mbi analizën e varfërisë dhe e ndikimit social (PSIA) për të matur dhe ndjekur gabimet e përfshirjes dhe të përjashtimit të reformës së PAK-së, pasi të jetë shtrirë në të paktën gjysmën e vendit, duke përfshirë dhe një studim për vlerësimin e përfituesve të PAK-së

1. Konteksti

Qeveria e Shqipërisë nënshkroi një marrëveshje për hua shtesë me Bankën Botërore, sa i përket Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP), që mbështet zbatimin e reformave të Shqipërisë për përmirësimin e barazisë dhe të eficiencës së programeve të asistencës sociale, NE-së dhe ndihmës për aftësinë e kufizuar. Pritej që financimi shtesë të kontribuonte në përmirësimin e mëtejshëm të barazisë dhe të eficiencës së sistemit të asistencës sociale. Objektivi i barazisë pritej të mbështetej përmes:

- Përshkallëzimit të kriterëve të reja për të përcaktuar pranueshmërinë për ndihmën për aftësinë e kufizuar, bazuar në modelin social, minimalisht deri në nivelin e gjysmës së popullsisë së vendit;

- Përmirësimit të aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara në qendrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), ku merren vendimet përfundimtare lidhur me pranueshmërinë;

- Harmonizimit të vlerësimit dhe të kriterëve të pranueshmërisë, si për përfitimet kontribuese për aftësinë e kufizuar, po ashtu dhe për ato jokontribuese;

- Promovimit të përfshirjes sociale të Programit Ndihma Ekonomike (PNE) në periudhën kalimtare të daljes nga programi i pagesave në *cash* të NE-së.

Objektivi i eficiencës pritej të mbështetej përmes:

- Krijimit dhe përdorimit të raporteve të automatizuara MIS për menaxhimin e performancës së PAK-së; dhe

- Përmirësimit të mbikëqyrjes dhe të kontrollit të përfitimeve të ndihmës për aftësinë e kufizuar.

Reforma e ndihmës për aftësinë e kufizuar, që është pjesë e këtij programi, u krijua përmes një procesi të udhëhequr nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), si dhe institucione të tjera, si Shërbimi Social Shtetëror, Zyrat e Punësimit; si dhe ekspertë dhe mjekë të institucioneve vartëse të këtij institucioni. Reforma u projektua si një zbatim i udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të parashikuara në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (KNF) dhe Grupit të Uashingtonit për Statistikat e Aftësisë së Kufizuar. Kjo reformë përfshiu përvojën ndërkombëtare të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe ofrimin e përfitimeve për aftësinë e kufizuar në sistemin jokontribues, duke marrë parasysh kontekstin profesional, kulturor, socio-ekonomik, legjislativ dhe politiko-administrativ të Shqipërisë. Iu kushtua rëndësi e veçantë përputhshmërisë me të gjitha dispozitat përkatëse të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Objektivat e reformës së programit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Shqipëri janë:

- Ristrukturimi i modelit ekzistues të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe përcaktimi i përfitimeve përkatëse, një vlerësim që aktualisht mbështetet vetëm në të dhëna mjekësore, përmes përfshirjes së qasjes biopsikosociale të Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (KNF). Kjo qasje funksionale do të marrë në konsideratë ndërveprimin ndërmjet problemeve shëndetësore (sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet) dhe faktorëve kontekstualë (faktorët mjedisorë dhe ata personalë) në veprimtaritë e përditshmërisë në përputhje me moshën.

- Sigurimi i shpërndarjes së drejtë të parave të taksapaguesve për kategoritë e ndryshme të aftësisë së kufizuar, për të përmbushur nevojat e tyre të veçanta të shkaktuara nga aftësia e kufizuar, për të nxitur mbështetjen sociale dhe për të mbajtur në mënyrë graduale një cilësi jete të krahasueshme me standardet e vendit.

- Përfshirja, krahas vlerësimit, e procesit të përgatitjes së planit individual shumëdisiplinor të mbështetjes, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të përmbushin nevojat e tyre mjekësore, psikologjike dhe sociale, si dhe të reduktohen barrierat ndaj përfshirjes sociale.

- Riorganizimi i administrimit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për përmirësimin e efikasitetit, rritjen e llogaridhënies përmes krijimit të kontrolleve dhe të bilanceve, si dhe reduktimin e gabimeve dhe të mashtrimit.

Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar nisi me një program pilot në fillim të muajit prill 2017, dhe u zhvillua në Bashkinë Tiranë, në njësitë administrative nr. 6 dhe 7. Qëllimi kryesor i projektit pilot ishte testimi dhe paraqitja e modelit të ri të vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar, si dhe skemës së sapopropozuar të përfitimeve dhe marrjen e informacioneve për masat që duhet të ndiqen për të garantuar një zbatim të suksesshëm në shkallë më të gjerë. Objektivat kryesorë ishin, si më poshtë: 1. Testimi i procedurës së propozuar për vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar; 2. Testimi i dokumenteve të propozuara (manualët dhe formularët) për vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar; 3. Testimi i softuerit për vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar; 4. Ngritja e kapacitetit teknik për vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar; 5. Krijimi i bazës për administrimin e vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar; 6. Ngritja e rrjetit mbështetës për vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar dhe promovimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve; 7. Testimi i realizueshmërisë ekonomike të skemës së re të përfitimeve; 8. Testimi i pranueshmërisë nga përdoruesit i skemës së re të përfitimeve dhe i qasjes së vlerësimit; dhe 9. Identifikimi i fushave për përmirësim përpara zbatimit në shkallë më të gjerë. Më pas, projekti pilot u ndoq nga përshkallëzimi i reformës në qarkun e Tiranës, në dhjetor të vitit 2019, në qarkun e Durrësit, në shtator të vitit 2021 dhe në qarkun e Elbasanit, në tetor të vitit 2021.

Anketa e Analizës së Varfërisë dhe Ndikimit Social (PSIA) për aftësinë e kufizuar, e zhvilluar në tetor të vitit 2011, siguroi statistikën fillestare lidhur me aftësitë funksionale¹. Analiza paraprake e anketës tregon se 14% e përfituesve të ndihmës për aftësinë e kufizuar nuk raportojnë paaftësi funksionale (bazuar në listën e shkurtër të pyetjeve nga Grupi i Uashingtonit). Projekti SAMP, me financim shtesë, parashikon kryerjen e një studimi/ankete tjetër për aftësinë e kufizuar, për të mbështetur monitorimin e reformave të përfitimeve për aftësinë e kufizuar, përmes vlerësimit të pavarur të aftësive funksionale të raportuara të përfituesve.

Aktualisht, MSHMS-ja po kërkon shërbimet nga një organizatë konsulente vendëse (referuar në vijim si “Konsulenti”), që do të jetë përgjegjëse për hartimin dhe për zhvillimin e pyetësorit, mbledhjen e të dhënave dhe analizën e tyre, si dhe për hartimin e raportit, për: 1. anketën vijuese të PSIA-s për të matur dhe për të ndjekur gabimet e përfshirjes dhe të përjashtimit të reformës së PAK-së; dhe 2. një anketë për vlerësimin e përfituesve për përfituesit e programit të PAK-së, për të vlerësuar nivelin e tyre të kënaqësisë me reformën e PAK-së.

2. Objektivat

Objektivat kryesorë të kësaj detyre janë:

- Matja dhe ndjekja e gabimeve të përfshirjes dhe të përjashtimit të reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar në tri qarqet pilot (Tiranë, Durrës dhe Elbasan);

- Vlerësimi i nivelit të kënaqësisë së përfituesve me vlerësimin, konkretisht “përqindja e përfituesve të PAK-së në tri qarqet pilot, që janë të kënaqur me aksesin, cilësinë e strukturave, cilësinë e shërbimeve dhe përgjigjen ndaj nevojave të tyre”.

3. Përshkrimi i shërbimeve të mbledhjes së të dhënave

Kërkimi do të përbëhet nga dy komponentë kryesorë:

- a) Komponenti kërkimor sasior**, që do të anketojë personat me aftësi të kufizuara, që kanë marrë vërtetim aftësie të kufizuar kohët e fundit, dhe personat me aftësi të kufizuara, që iu refuzua dhënia e këtij vërtetimi.

- b) Komponenti kërkimor cilësor**, që synon anketimin e personave me aftësi të kufizuara për të kuptuar nivelin e kënaqësisë së tyre me sistemin e ri të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

3.1. Kërkimi sasior

3.1.1 Grupet e synuara

Anketa do të mbulojë tri grupe kryesore të synuara:

- 1. Personat që janë vlerësuar së fundmi²** në tri qarqet (Elbasan, Durrës dhe Tiranë), sipas skemës së re të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe që u është dhënë vërtetim si persona me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor i analizës është matja e aftësive të tyre të kufizuara funksionale, si dhe e nivelit të tyre të kënaqësisë me mënyrën e trajtimit gjatë vlerësimit.

- 2. Personat që janë vlerësuar së fundmi** në tri qarqet (Elbasan, Durrës dhe Tiranë), **sipas skemës së vjetër të vlerësimit të aftësisë së kufizuar**, dhe që u është dhënë vërtetim si persona me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor i kësaj analize është pasja e një grupi krahasimi për analizën e personave me vërtetim, sipas sistemit të ri (sa u përket kënaqësisë me vlerësimin dhe aftësive të kufizuara funksionale).

- 3. Personat që nuk kanë marrë vërtetim aftësie të kufizuar (të refuzuar), sipas skemës së re.** Qëllimi i kësaj analize është matja e aftësive të tyre të kufizuara funksionale, si dhe e nivelit të tyre të kënaqësisë me mënyrën e trajtimit gjatë vlerësimit.

3.1.2 Kampionimi

Kampioni do të jetë i llojit me shumë faza dhe probabilitar (ku çdo pjesëtar i popullatës së synuar duhet të ketë një probabilitet të njohur dhe të vlefshëm për t’u përfshirë në kampion), me karakteristikat vijuese:

¹ Kjo anketë përfaqësuese në nivel kombëtar u bazua në përkufizimin funksional të aftësisë së kufizuar, sipas Listës së Shkurtër të Pyetjeve nga Grupi i Uashingtonit, për gjashtë fushat e aftësisë së kufizuar (konkretisht, shikimi, dëgjimi, lëvizshmëria, kujtesa, kujdesi për veten dhe komunikimi).

² Në varësi të numrit të rasteve të disponueshme në nivel njësie administrative, “së fundmi” do të përfshijë një periudhë nga 3 deri në 5 muaj.

Dy kampionët e personave që kanë marrë vërtetim të aftësisë së kufizuar, sipas skemës së re të vlerësimit dhe skemës së vjetër, do të shtresëzohen sipas qarkut, konkretisht Elbasan, Durrës dhe Tiranë. Tri shtresat do të kenë madhësi të njëjtë, me qëllim krahasimin më efektiv sipas qarqeve. Në rastin e personave që iu refuzua vërtetimi, sipas skemës së re, për shkak të përmasave të vogla të kësaj popullate të synuar dhe të shpërndarjes territoriale të saj, ky kampion do të përzgjidhet pa shtresëzim paraprak.

Njësitë primare të kampionimit (NJPK-të) do të përfaqësohen nga njësitë administrative (16 njësi administrative në Durrës, 50 në Elbasan dhe 29 në Tiranë). Përzgjedhja nga njësitë primare të kampionimit do të kryhet me probabilitet proporcional me madhësinë (lokalitetet me më shumë persona do të kenë probabilitet më të madh për t'u përzgjedhur). Me qëllim reduktimit e gabimeve standarde, 60 deri në 70 njësi administrative do të përzgjidhen gjithsej në kampion. Lista e lokaliteteve që do të përfshihen në kampion do të mundësohet nga MSHMS-ja brenda dy javësh nga nënshkrimi i kontratës.

Nga çdo lokalitet i përcaktuar, MSHMS-ja do të përzgjedhë listën e personave që do të pyeten dhe do t'ia dorëzojë atë Konsulentit. Lista e personave do të mundësohet brenda një jave, pasi MSHMS-ja të marrë raportin pilot.

Vëllimi i përgjithshëm i kampionit do të përbëhet nga 2946 adresat që do të vizitohen. Duke përlogaritur një përqindje kontakti prej të paktën 80% dhe përqindje përgjigjeje të paktën 70%, madhësia e kampionit nuk duhet të jetë më e vogël sesa 1650 persona, sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 1: Madhësitë e kampionit
(numri i adresave që do të vizitohen dhe madhësia minimale e kampionit për tri nënkampionet)

	Tiranë	Elbasan	Durrës
Personat me vërtetim të aftësisë së kufizuar, sipas skemës së re – Numri i përgjithshëm i vlerësuar nga muaji nëntor 2021 deri në muajin mars 2022	4112	2284	1373
Madhësia e kampionit – Personat që do të vizitohen	536	536	536
Madhësia minimale e nevojshme e kampionit	300	300	300
Personat e vlerësuar sipas skemës së vjetër të vlerësimit të aftësisë së kufizuar – Numri i përgjithshëm i vlerësuar nga muaji nëntor 2021 deri në muajin mars 2022	1763	12117	9071
Personat që do të vizitohen	357	357	357
Madhësia minimale e nevojshme e kampionit	200	200	200
Personat e refuzuar sipas skemës së re – Numri i përgjithshëm i vlerësuar nga muaji nëntor 2021 deri në muajin mars 2022	282	36	58
Personat që do të vizitohen			267
Madhësia minimale e nevojshme e kampionit			150

Shpërndarja e tri kampioneve sipas qarqeve, bashkive dhe njësive administrative paraqitet në shtojcë.

3.1.3 Pyetësi/ët

MSHMS-ja do të paraqesë një version paraprak të pyetësit, që do të pilotohet dhe finalizohet nga Konsulenti. Mesatarisht, intervista me një person me aftësi të kufizuara parashikohet të zgjasë rreth 30 minuta. Konsulentit do t'i duhet të përgatisë edhe pjesën tjetër të materialeve/instrumenteve të mbledhjes së të dhënave (letrat hyrëse, marrëveshjet lidhur me përpunimin e të dhënave personale, fletët e kampionit, udhëzimet etj.), që do të diskutohen dhe do të dakordësohen bashkërisht me ekipin e MSHMS-së.

Për secilin nga tri nënkampionet do të përgatiten pyetësorë të veçantë. Pyetësorët do të përmbajnë modulet e mëposhtme:

- **Një modul sociodemografik**, që përfshin: informacion në nivel individual (mosha e personit, lloji dhe niveli i aftësisë së kufizuar, të ardhurat e përgjithshme, niveli i arsimit, statusi i punësimit, koha e vlerësimit të personit); informacion në nivel familjeje (numri i pjesëtarëve të familjes, sa fëmijë, sa të rritur në moshë pune dhe sa të moshuar).

- **Lista e gjatë e pyetjeve nga Grupi i Uashingtonit** (pa përfshirë pyetjet fakultative).³

³ <https://www.washingtongroup->

- Lista me 12 pyetje e **WHODAS 2.0**.⁴
- **Një modul lidhur me kënaqësinë për vlerësimin** (aksesi, cilësia e strukturave, cilësia e shërbimeve dhe përgjigja ndaj nevojave të tyre). Përfutuesve do t'u shpjegohet qartë se duhet të raportojnë nivelin e kënaqësisë së tyre me vlerësimin, jo me përfitimet që marrin.
- **Një modul për të gjitha përfitimet për aftësinë e kufizuar** që marrin (llojet dhe nivelet), si dhe nivelin e kënaqësisë së tyre me to.
- **Një listë e shkurtër pyetjesh rreth vështirësive financiare, me të cilat personi përballet si pasojë e aftësisë së kufizuar.** Pyetjet duhet të pasqyrojnë çështje, si: niveli minimal i përfitimeve që u nevojitet për të mbuluar kostot shtesë të aftësisë së kufizuar, si dhe llojet e kostove që nuk arrijnë të mbulojnë, për shkak se përfitimet janë të pakta.

3.1.4 Mënyra e zhvillimit të intervistave/mbledhjes së të dhënave

Të gjitha intervistat do të zhvillohen ballë për ballë, në shtëpitë e personave të përzgjedhur në kampion, mundësisht duke përdorur intervistimin personal me asistencë kompjuterike/tablete (CAPI). Gjithashtu, pritet që edhe fletët e kampionit dhe shqyrtimi i të intervistuarve të kryhet duke përdorur CAPI-n.

Mundësisht, shoqëritë do të propozojnë zgjidhje CAPI që integrojnë intervistimin me menaxhimin e kampionit, monitorimin e veprimtarisë në terren dhe kontrollin e cilësisë, në mënyrë që për çdo person nga lista e mundësuar nga MSHMS-ja të krijohet një rast i veçantë i regjistruar në bazën e të dhënave, ku përfshihet i gjithë informacioni, duke filluar nga veçoritë lidhur me shtresëzimin, rezultatet e fazave të ndryshme të procesit të mbledhjes së të dhënave (numri i përpjekjeve për kontakt, arsyet për mungesën e kontaktit/refuzimin, kontrollet e mëpasshme etj.).

Shoqëria kërkimore duhet të krijojë një strategji për minimizimin e mungesës së kontaktit dhe për të siguruar se të intervistuarit e mundshëm nuk do të përjashtohen nga anketa, për shkak të mënyrës ose periudhës në të cilën bëhen përpjekjet për kontakt. Kërkesa është që çdo adresë në kampion të vizitohet të paktën 3 herë, në ditë të ndryshme të javës, dhe se të paktën 4 ditë duhet të kalojnë ndërmjet vizitës së parë dhe asaj të fundit.

3.1.5 Pilotimi

Konsulenti do të kryejë një test pilot, për të siguruar se të gjitha instrumentet kërkimore dhe procedurat e mbledhjes së të dhënave funksionojnë në mënyrën e parashikuar dhe të projektuar. Testi pilot duhet të trajtohet si një provë e përgjithshme, ndaj duhet të përdorë të njëjtat qasje, materiale, protokolle dhe infrastrukturë, si veprimtaria e vërtetë e mbledhjes së të dhënave. Kjo do të thotë se të gjitha materialet e fushës dhe shkresat për CAPI-n duhet të jenë përgatitur përpara testit pilot dhe të jenë miratuar nga ekipi i MSHMS-së, dhe se infrastruktura teknike e shoqërisë së përzgjedhur duhet të jetë funksionale. Testi pilot duhet të kryhet nga specialistë me përvojë. Krahas kësaj, operatorët në terren të përfshirë në testin pilot duhet të jenë, gjithashtu, me përvojë.

Testi pilot duhet të kryhet me të paktën 5 individë nga çdo nënkampion i përzgjedhur nga 3 NJPK-të, nga lokalitete dhe bashki të ndryshme, të zgjedhura veçmas kampionit të anketës (lista e individëve do të mundësohet nga MSHMS-ja). Pas çdo interviste të kryer në testin pilot, operatorët do të diskutojnë me të intervistuarit për të identifikuar pyetjet që ishin të vështira për t'iu përgjigjur.

3.1.6 Organizimi i veprimtarisë në terren

Operatorët në terren dhe mbikëqyrësit që punojnë në këtë projekt duhet të kenë përvojë me anketat e bazuara në intervistat ballë për ballë, duke përdorur CAPI-në. Shoqëria duhet të ketë një rrjet operatorësh fushe me përvojë, të aftë të kryejnë veprimtarinë e mbledhjes së të dhënave, duke respektuar kërkesat në këta terma referencë, standardet e cilësisë, si dhe periudhën kohore të përcaktuar. Konsulenti duhet të sigurojë se numri i mbikëqyrësve dhe i operatorëve të

disponueshëm për të kryer veprimtarinë përkatëse në terren, me normë relativisht të barabartë gjatë gjithë periudhës së mbledhjes së të dhënave, është i mjaftueshëm.

Çdo operatori dhe mbikëqyrësi do t'i caktohet një kod unik identifikimi, që do të përdoret gjatë gjithë periudhës kërkimore dhe që do të shënohet në çdo dokument fizik ose elektronik që rezulton nga veprimtaria e tyre në terren.

Veprimtaria e mbledhjes së të dhënave në terren do të zhvillohet në bazë të udhëzimeve të detajuara dhe koherente, të përgatitura nga shoqëria kontraktuese, të cilat duhet të analizohen dhe të miratohen nga Banka Botërore, përpara nisjes së veprimtarisë në terren. Njëkohësisht, të gjithë operatorët dhe mbikëqyrësit do të ndjekin seanca trajnimi të posaçme për projektin. Si udhëzimet me shkrim, po ashtu dhe trajnimi, duhet të përcaktojnë mënyrën e përdorimit të instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, procedurën që do të ndiqet për përzgjedhjen e të intervistuarve dhe mënyrën e zhvillimit të intervistave. Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë përdorimit të sistemit CAPI. Seancat e trajnimit do të ndiqen edhe nga një përfaqësues i MSHMS-së.

Shoqëria e kontraktuar do të sigurojë se operatorët që punojnë në këtë anketë do të monitorohen gjatë gjithë periudhës së veprimtarisë në terren dhe do të kontrollohen sistematikisht, sa i përket cilësisë së punës së tyre. Me qëllim verifikimit të cilësisë së punës së operatorëve, të dhënat administrative të anketës do të analizohen dhe do të kryhen kontrole efektive përmes telefonit ose takimit sërish me të intervistuarit. Është e rëndësishme që verifikimi i operatorëve të kryhet vazhdimisht gjatë periudhës në terren, në mënyrë që të monitorohet mënyra e zbatimit të procedurave të dakordësuara të kontaktit dhe të intervistimit nga ana e tyre. Shoqëria e kontraktuar do të duhet të verifikojë të paktën 10% të intervistave të zhvilluara. Përzgjedhja e kampionit që do të verifikohet do të kryhet nga ekipi i koordinimit i shoqërisë së kontraktuar, dhe çdo operatori duhet t'i verifikohet të paktën një intervistë. Parregullsitë e konstatuara do të regjistrohen në regjistrin e verifikimit, duke përcaktuar edhe nivelin e parregullsisë dhe masat e ndërmarra për korrigjim. Në rast se konstatohen parregullsi serioze gjatë verifikimit të intervistës së një operatori, atëherë do të verifikohen të gjitha intervistat e zhvilluara nga operatori në fjalë përpara intervistës së zbuluar. Asnjë intervistë që është konstatuar se ka parregullsi serioze nuk do të konsiderohet si pjesë e grupit të të dhënave.

Konsulentit do t'i duhet të përgatisë një plan për monitorimin e operatorëve në terren, duke përfshirë klasifikimin e parregullsive, si dhe protokollin që duhet të ndiqet në rastin e konstatimit të parregullsive, ku ky plan do t'i dorëzohet MSHMS-së përpara nisjes së veprimtarisë në terren.

Çdo javë, Konsulenti do të regjistrojë ecurinë e veprimtarisë në terren dhe do të japë prova se operatorët po verifikohen sipas planifikimit, konkretisht për të siguruar informacion mbi numrin e intervistave të kontrolluara, numrin dhe llojin e parregullsive të gjetura dhe masat korrigjuese të marra. Regjistrat dhe provat përbëjnë pjesë thelbësore të raporteve.

3.1.7 Përpunimi i të dhënave

Verifikimi i të dhënave

Verifikimi i të dhënave pritet të kryhet në kohë reale, duke përdorur sistemin CAPI. Verifikimi i të dhënave duhet të kryhet në të paktën 2 nivele: 1. Në nivelin e ndryshoreve – rangu i vlerave të pranuar për çdo ndryshore duhet të përcaktohet dhe sistemi duhet të verifikojë nëse regjistrat përkojnë me rangun; 2. Në nivelin e personit – për çdo person në kampion, të dhënat e mbledhura duhet të jenë të njëtrajtshme, çka do të thotë se duhet të përcaktohen rregulla që synojnë kombinimet e vlerave të lejuara ndërmjet ndryshoreve midis së cilave ekzistojnë marrëdhënie logjike dhe të dhënat e regjistruara për çdo person duhet të verifikohen sa i përket përputhshmërisë me të gjitha rregullat në fjalë.

Ponderimi

Për shkak të kampionimit dhe mospërgjigjes, ka gjasë të ekzistojnë ndryshime ndërmjet kampionit dhe popullatës referencë dhe, për këtë arsye, nevojitet kryerja e ponderimit të të dhënave. Konsulenti do të ketë për detyrë përlllogaritjen e ponderimit, duke marrë parasysh probabilitetet e pabarabarta të përzgjedhjes në çdo fazë të kampionimit, si dhe përqindjet e

ndryshme të mospërgjigjes. Njëkohësisht, pritet që shoqëria e kontraktuar të përlogarisë ponderimin pas shtresëzimit, duke përdorur të dhënat e mundësuar nga MSHMS-ja.

3.1.8 Analiza e të dhënave

Konsulenti do të përgatisë një raport me tabela të thjeshta për grupet e mëposhtme të treguesve të përlogaritur për secilin nga tri kampionet:

- Profili sociodemografik (mosha e personit, lloji dhe niveli i aftësisë së kufizuar, të ardhurat mesatare, niveli i arsimit, statusi i punësimit, numri i pjesëtarëve të familjes);
- Niveli i përgjithshëm i funksionimit, duke përdorur listën e pyetjeve nga Grupi i Uashingtonit, si dhe niveli i funksionimit sipas pikave;
- Aftësia e kufizuar e përgjithshme, duke përdorur WHODAS 2.0;
- Kënaqësia e përgjithshme me vlerësimin dhe kënaqësia me çdo nënkriter;
- Përfitimet për aftësinë e kufizuar (personat që i marrin dhe nivelet përkatëse) dhe kënaqësia e përgjithshme me përfitimet;
- Analizë e vështirësive financiare me të cilat personi përballët si pasojë e aftësisë së kufizuar.

3.2 Kërkimi cilësor

3.2.1 Projektimi i kërkimit

Firma anketuese do të përcaktojë 8 fokus grupe. Çdo fokus grup do të përfshijë 6–8 persona me aftësi të kufizuara dhe do të përfshijë një diskutim prej dy orësh me pjesëmarrësit. Pjesëmarrësit do të jenë të larmishëm sa i përket nivelit dhe llojit të aftësisë së kufizuar, gjinisë, moshës dhe zonave banuese.

Kategoria	Fokusgrupet
Personat me vërtetim për aftësinë e kufizuar sipas skemës së re*	3 fokusgrupe (Tiranë, Elbasan, Durrës) – të paktën një në zonat rurale
Personat e vlerësuar sipas skemës së vjetër të aftësisë së kufizuar*	3 fokusgrupe (Tiranë, Elbasan, Durrës) – të paktën një në zonat rurale
Personat e refuzuar sipas skemës së re*	2 fokusgrupe (Tiranë, Durrës)

* Personat e vlerësuar së fundmi (gjatë 5 muajve të fundit)

3.2.2. Temat dhe analiza

Gjatë intervistave do të diskutohen temat e mëposhtme:

- Kënaqësia me vlerësimin (sipas fazës së vlerësimit) dhe mënyrat se si vlerësimi mund të përmirësohet;
- Kënaqësia me përfitimet për aftësinë e kufizuar dhe mënyrat se si sistemi i përfitimeve mund të përmirësohet;
- Llojet e vështirësive me të cilat personat përballen si pasojë e aftësisë së tyre të kufizuar dhe mënyra se si mund t'i tejkalojnë ato me mbështetjen e duhur.

Raporti do të përmbledhë problematikat e identifikuara gjatë intervistave për secilën nga tri grupet.

4. Periudha e parashikuar e zbatimit dhe raportimi

Kontrata me shoqërinë e përzgjedhur për ofrimin e shërbimeve të mbledhjes së të dhënave do të lidhet për një periudhë prej 4 muajsh.

Kërkimi sasior	
Faza përgatitore	
Vërejtjet fillestare për formatin paraprak të pyetësorit të dorëzuar nga MSHMS-ja	1 javë pas nënshkrimit të kontratës
Pyetësori në formatin CAPI për testin pilot	1 muaj pas nënshkrimit të kontratës
Udhëzimet e pilotimit; grupi i të dhënave që vijnë nga pilotimi; raporti i pilotimit	
Plani i sigurimit të cilësisë; strategjia e monitorimit të operatorëve	1 muaj e dy javë pas nënshkrimit të kontratës
Pyetësori përfundimtar; materialet dhe udhëzuesi përfundimtar i fushës; seancat e trajnimit të zhvilluara për operatorët	

Faza e zbatimit		
Raporte vëzhguese javore		
Grupi i ndërmjetëm i të dhënave, që përmban 50% të kampionit të parashikuar dhe të pyetësorëve të përfunduar gjatë dy javëve të para të punës në terren (në format SPSS dhe STATA)		2 muaj e një javë pas nënshkrimit të kontratës
Grupi përfundimtar i të dhënave, që përmban 100% të kampionit të parashikuar dhe pyetësorëve të realizuar gjatë punës në terren (të koduar, shqyrtuar dhe ponderuar, duke përfshirë të dhënat administrative për çdo rast të kampionit, në format SPSS dhe STATA)		3 muaj pas nënshkrimit të kontratës
Raporti teknik dhe raporti që lidhet me veprimtarinë e mbledhjes së të dhënave (duke përfshirë verifikimin e të dhënave dhe verifikimin e rezultateve, si dhe treguesit e cilësisë) ⁵		
Faza e analizës		
Një raport i shkurtër ku përmbledhen treguesit kryesorë nga anketa për secilën nga tri kampionet		3 muaj e dy javë
Kërkimi cilësor		
Faza përgatitore		
Metodologjia e kërkimit – formati fillestar (duke përfshirë udhëzuesit për intervistat)		1 muaj pas nënshkrimit të kontratës
Metodologjia përfundimtare e kërkimit		1 muaj e gjysmë pas nënshkrimit të kontratës
Faza e zbatimit		
Intervistat e zhvilluara		2 muaj pas nënshkrimit të kontratës
Faza e analizës		
Raporti i finalizuar		3 muaj pas nënshkrimit të kontratës
Raportet		
Raporti fillestar		Afati kohor
Raporti i ndërmjetëm		Dy javë pas nënshkrimit të kontratës
Projektraporti përfundimtar		1 muaj e gjysmë pas nënshkrimit të kontratës
Raporti përfundimtar		3,5 muaj pas nënshkrimit të kontratës
		4 muaj pas nënshkrimit të kontratës

Konsulenti do t'i raportojë zëvendësministrit të MSHMS-së dhe drejtorit të Drejtorisë së Përkujdesjes dhe Shërbimeve Sociale të Integruara në MSHMS. Të gjitha raportet dhe produktet e dorëzueshme i nënshtrohen pranimi dhe janë përgjegjësi e drejtorit të DPSHSI-së.

Të gjitha raportet hartohen në gjuhën shqipe dhe angleze (në tri kopje origjinale secili) dhe i adresohen:

- zëvendësministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, MSHMS;
- drejtorit të DPSHSI-së, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, MSHMS;
- Menaxherit të SAMP-së.

5. Përgjegjësitë dhe detyrimet

Konsulenti do të punojë nga afër dhe do t'i raportojë drejtpërdrejt Drejtorisë së Përkujdesjes dhe Shërbimeve Sociale të Integruara (DPSHSI) në MSHMS dhe ekipit të caktuar të Bankës Botërore.

Banka Botërore dhe MSHMS-ja do të ofrojnë:

- Udhëzim përgjatë të gjitha fazave të zbatimit.
- Miratimin e të gjitha produkteve të dorëzueshme, duke përfshirë nënshkrimin përfundimtar të letrës së pranimi për të kryer pagesat.

Konsulenti do të jetë përgjegjës, për:

- përgatitjen e të gjitha produkteve të përshkruara në tabelën e mësipërme;

⁵ Raporti do të përfshijë mënyrën e zbatimit të metodologjisë së kampionimit, rezultatet e marra lidhur me adresat e vizituara, përqindjet e kontaktit, përqindjet e përgjigjeve për personat e kontaktuar dhe përqindjet e përgjithshme të përgjigjes. Shifrat do të kategorizohen sipas njësive administrative dhe tri nënkampioneve.

- raportimin e rregullt të ecuresë të Drejtoria e Përkujdesjes dhe Shërbimeve Sociale të Integruara në MSHMS.

6. Kualifikimet e Konsulentit

Kjo veprimtari do të kërkojë një konsulent me njohuri të larta për praktikën më të mirë vendëse, sa u përket anketave sociale dhe përvojë të dëshmuar me zhvillimin e anketave të ngjashme. Shoqëria duhet të jetë në gjendje të angazhojë anketues të kualifikuar, staf për hedhjen e të dhënave, kontrollorë cilësie dhe staf analitik, sipas dakordësimit në kontratë, si dhe duhet të zotërojë kapacitetin logjistik për zhvillimin e anketës brenda afatit kohor të studimit.

Konsulenti duhet të ketë një historik të dëshmuar me kryerjen e veprimtarive të ngjashme.

Kriteret minimale të kualifikimit për përzgjedhje janë:

- Konsulenti duhet të jetë një organizatë e themeluar me të paktën 3 vjet ushtrim veprimtarie;
- Konsulenti duhet të ketë realizuar të paktën një anketë të ngjashme në 5 (pesë) vjetët e fundit.

Kriteret e vlerësimit dhe pikët përkatëse janë si vijon:

- Përshkrimi i profilin të shoqërisë; historiku përkatës dhe stafi (30 pikë);
- Përshkrimi i punëve/veprimtarive më me rëndësi dhe të ngjashme në 10 vjetët e fundit, që tregojnë aftësitë e duhura të mbledhjes së të dhënave, analizës së të dhënave, pyetësorëve, aftësive intervistuese dhe monitorimit. Dhënie e informacionit lidhur me veprimtari të përfunduara dhe/ose në proces: emri i veprimtarisë/projektit, burimi i financimit, kostoja, kohëzgjatja, roli si partner i vetëm dhe/ose anëtar i një SP-je) (70 pikë/7 pikë për çdo anketë të ngjashme dhe 5 pikë për anketa në shkallë më të vogël, me një shumë kumulative prej 70 pikësh gjithsej).

7. Përbërja e ekipit

Duhet të ketë një ekip shumëdisiplinor, me përvojë të konsiderueshme dhe njohje të anketave të mbrojtjes/asistencës sociale dhe të kuptuar thelbësor të zhvillimit procedural, institucional dhe social në përgjithësi.

Konsulenti duhet të paraqesë një ekip me kualifikimet e mëposhtme:

- **Eksperti kyç 1** – Drejtues ekipi me të kuptuarit e nevojshëm të shërbimeve të mbrojtjes sociale, me përvojë statistikore dhe anketuese, bashkërisht me njohuri mbi projektimin e bazës së të dhënave dhe menaxhimin e detyrave;

Drejtuuesi i ekipit duhet të zotërojë një diplomë të nivelit të lartë në ekonomi, shkencë politike/statistikë ose diplomë të barasvlershme, si dhe një formim të konsiderueshëm në mikroekonomi dhe statistikë (master ose doktoraturë). Duhet të ketë zhvilluar anketa sociale për projekte në shkallë të gjerë dhe komplekse, mundësisht me BB-në. Duhet të ketë të paktën 10 vjet përvojë të përgjithshme profesionale edhe të paktën 5 vjet përvojë menaxhimi me zbatimin e projekteve për anketat, vlerësimin dhe monitorimin, duke pasur përvojë të dëshmuar në menaxhimin e projekteve dhe zhvillimin, koordinimin, hartimin dhe analizimin e anketave socio-ekonomike, projektimin dhe zbatimin e studimeve dhe anketave, veçanërisht me përdorimin e intervistave të gjysmëstrukturuara, vëzhgimeve, fokusgrupeve dhe/ose teknikave të tjera të gjykimit në grup.

Eksperti kyç 2 – Ekspert kërkimor i bazës së të dhënave/statisticien. Ai/ajo duhet të zotërojë një diplomë të nivelit të lartë në ekonomi, matematikë ose diplomë të barasvlershme, si dhe një formim të konsiderueshëm në mikroekonomi dhe statistikë (master ose doktoraturë). Të ketë të paktën 8 vjet përvojë të përgjithshme profesionale dhe minimumi pesë vjet përvojë me kërkimin në terren sa i përket projektimit dhe zbatimit të studimeve dhe anketave, veçanërisht me përdorimin e intervistave të gjysmëstrukturuara, vëzhgimeve, fokusgrupeve dhe/ose teknikave të tjera të gjykimit në grup.

Përvoja në terren me kërkimin për shërbimet e mbrojtjes sociale përbën avantazh.

Eksperti kyç 3 – Ekspert i kërkimit sasior, me fokus tek organizimi i të dhënave parësore për analizë të mëtejshme.

Ai/ajo duhet të zotërojë një diplomë të nivelit të lartë në ekonomi, matematikë, shkenca politike, statistikë ose diplomë të barasvlershme, si dhe një formim të konsiderueshëm në statistikë. Të ketë të paktën 8 vjet përvojë të përgjithshme profesionale dhe të paktën 5 vjet përvojë menaxhimi me projektet e anketimit, vlerësimit dhe monitorimit.

Të ketë të paktën pesë vjet përvojë me kërkimin në terren sa i përket projektimit dhe zbatimit të studimeve dhe të anketave, veçanërisht me përdorimin e intervistave të gjysmëstrukturuara, vëzhgimeve, fokusgrupeve dhe/ose teknikave të tjera të gjykimit në grup.

Përvojë në terren me kërkimin për shërbimet e mbrojtjes sociale.

Eksperti kyç 4 – Ekspert social me kompetencë dhe përvojë të gjerë në shërbimet e mbrojtjes sociale; të paktën 5+ vjet përvojë në sektorin e shërbimit të mbrojtjes sociale. Nëse eksperti nuk zotëron një diplomë të barasvlershme me nivelin master, atëherë konsulenti duhet të ketë të paktën 8 vjet përvojë.

Konsulenti duhet të jetë në gjendje të angazhojë një sërë ekspertësh për pozicionet jokyçe, si më poshtë:

- anketues të kualifikuar;
- të paktën një programues CAPI;
- staf për hedhjen e të dhënave;
- kontrollorë cilësie;

Konsulenti duhet të zotërojë kapacitetin logjistik për zhvillimin e anketës, brenda afatit kohor të studimit.

8. Kalendari i pagesave

Pagesa e parë: 20% në momentin e dorëzimit të raportit fillestar të pranueshëm për MSHMS-në.

Pagesa e dytë: 30% në momentin e dorëzimit të raportit të ndërmjetëm si më lart, të pranueshëm për MSHMS-në.

Pagesa e tretë: 50% në momentin e dorëzimit të raportit përfundimtar të pranueshëm për MSHMS-në.

9. Kohëzgjatja e kontratës

Konsulenti duhet të jetë një firmë konsultimi vendëse. Metoda e përzgjedhjes që do të ndiqet është ajo e Përzgjedhjes së Kualifikimit të Konsulentëve (CQ), në përputhje me procedurat e parashikuara nga “Rregullorja e prokurimit e Bankës Botërore për Huamarrësit e IPF-së”, e muajit korrik 2016.

Shërbimi duhet të kryhet brenda një afati kohor prej katër muajsh dhe përfshin të paktën 90 ditë pune/person për të gjithë stafin kyç dhe 350 ditë pune/person për të gjithë stafin jo kyç. Konsulenti pritet ta nisë shërbimin në muajin qershor/korrik 2022.

REQUEST FOR EXPRESSION OF INTEREST CONSULTING SERVICES FOR

PSIA (Poverty and Social Impact Analysis) follow up survey to measure and track the inclusion and exclusion errors of the DA reform once it is rolled out at least to half of the country including a beneficiary assessment survey for the DA beneficiaries

Ref. no. SAMP/CS/CQ/01-2022

Tirana, June 08, 2022

Social Assistance Modernization Project (SAMP)

Loan No.: 8841- AL
Project ID No.: P162079

